



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 21.06.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.3) të Rregullores për Prokurim Publik të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 19.06.2023, të parashtruar nga Operatori Ekonomik “**BERISHA COM**” SH.P.K lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Rregullimi i rrugëve fushore në zonat rurale”, Nr. i prokurimit- 632-23-5381-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-070 -521, **nxjerr:**

V E N D I M

1. **Aprovohet** si e bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik “**BERISHA COM**” SH.P.K., e dt.19.06.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Rregullimi i rrugëve fushore në zonat rurale**”, Nr. i prokurimit- 632-23-5381-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-070 -521, kundër Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë te AK –së të publikuar me datë 31.05.2023, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. **Përmirësohet DOSJA E TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË, i publikuar me datë: 31.05.2023;**

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të bëjë përmirësimin e Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

Arsyetim

Operatori Ekonomik "BERISHA COM" SH.P.K., me dt.19.06.2023, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Rregullimi i rrugëve fushore në zonat rurale", Nr. i prokurimit- 632-23-5381-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-070 -521.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 21.06.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj i parë lidhur me certifikimet e inxhinjerëve, është i bazuar dhe Autoriteti kontraktues vendos që të bëj përmirësimin e Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë;

Pretendimi juaj i dytë lidhur me pajisjet, është i bazuar dhe Autoriteti kontraktues vendos që të bëj përmirësimin e Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;

